




# Republika e Kosovës

Republika Kosovo / Republic of Kosovo



Njësia Nr./Br./No 01 (Kuvendi i Komunës)

Nr./Br./No 01/23 Nr. i faq./Br.str/No.pg 156

Data/Datum/Date 29/11/2023

Në mbështetje të nenit 12 pika 1 dhe pika 2 shkronja d), nenit 14 pika 1, nenit 17 shkronja (c) dhe nenit 40 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 24 paragrafi 4 i Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 2, nenit 10, paragrafi 2, pika 2.4, nenit 40, nenit 57, paragrafi 1, pika 1.3 dhe nenit 94, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, i datës 29.3.2017, Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 29.11.2023, miraton këtë:

## V E N D I M

### Shpalljen me interes të përgjithshëm publik pjesën e parcelës P-71510057-02240-1 në Zonën Kadastrale Rahovec

- Miratohet** propozimi i kryetarit të Komunës, me Nr. Prot. 02/3322/23, i datës 07.11.2023 dhe merret vendimi për shpalljen me interes të përgjithshëm publik pjesën e parcelës **P-71510057-02240-1** në Zonën Kadastrale Rahovec, në sipërfaqe prej 30000m<sup>2</sup> (tridhjetë mijë metra katror) nga sipërfaqja e përgjithshme prej 7577401m<sup>2</sup> (shtatë milion e pesëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e katërqind e një metra katror) në vendin e quajtur *shume-kabilja glava*, me kulturë Mal i klasës së 5-të, e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në posedim të P.Sh.E KOSOVES K.K.RAHOVEC ShF.EKO.E PYJ.RAHOVEC.
- Qëllimi i shpalljes së interesit të përgjithshëm publik të parcelës së cekur në pikën 1 të këtij vendimi, do të jetë këmbimi i pronës komunale me pronën e institucionit qendror. Për zhvillimin e aktiviteteve biznesore dhe t'u jepet mundësi qytetarëve të vetëpunësohen, ku rritja e aseteve ekzistuese ndihmon në rritjen e vlerës së asaj prone.
- Autorizohet kryetari i Komunës që, komform dispozitave ligjore në fuqi, t'i ndër marrë të gjitha veprimet e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.
- Bartës për rregullimin e dokumentacionit teknik dhe regjistrimin e pronës në Librin kadastral, do të jetë Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë në Komunën e Rahovecit.
- Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.
- Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose faqen ueb zyrtare të Komunës.

#### Vendimi u dërgohet:

- Anëtarëve të Kuvendit,
- Shërbimit të Kuvendit,
- Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë,
- MAPL-së, dhe
- Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01Nr.156/23  
Datë: 29.11.2023



Arbër Zenuni

Kryesues i Kuvendit